

11 Zeri, 30.10.2009

Zeri - E premta, 30 tetor 2009

Thelohet bashkëpunimi mes UP-së dhe universiteteve austriake

Fakulteti Juridik përfiton master në dy drejtime

Në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, shumë shpejt do të fillojnë ligjëratat për studime master në Drejtën Ndërkombëtare, dhe Drejtën Civile. Këto dy degë do të përkrahen nga organizata Vus-Austria

Një marrëveshje bashkëpunimi e nënshkruar dje mes drejtuesve të Universitetit të Prishtinës (UP), dhe zyrtarëve të organizatës Vus-Austria, mundëson zhvillimin e mëtutjeshëm të katër degëve të reja për studime master në UP.

I pranishëm në këtë ceremoni, Mujë Rugova, rektor i Universitetit të Prishtinës ka sqaruar se bëhet fjalë për master në menaxhim të shëndetësisë në kuadër të Fakultetit të Mjekësisë, program ky që është duke u zhvilluar në bashkëpunim me Universitetin e Mjekësisë në Vjenë, pastaj master në Mekatronikë, në kuadër të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike dhe Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, në të cilat programi për master është duke u zhvilluar në bashkëpunim me Universitetin e Shkencave të Aplikuara "FH Joanneum" në Grac.

Sipas rektorit Rugova, Fakulteti Juridik ka përfituar me dy programe nga kjo marrëveshje,

master në të Drejtën Ndërkombëtare, dhe master në Drejtën Civile dhe Pronësore, që të dy këto degë të zhvilluara në bashkëpunim me Universitetin e Grazit.

Rugova ka bërë të ditur se shumë shpejtë Universiteti i Prishtinës do të shpallë konkurs për pranimin e dyqind studentëve të rinj për këto drejtime, të cilët më pas do t'i fillojnë studimet.

Ndërsa But Dedaj, udhëheqës i organizatës Vus-Austria në Kosovë, ka thënë se studentët që duan të studiojnë në këtë degë duhet të dinë mirë gjuhën angleze, ngase sipas tij, programi do të jetë në këtë gjuhë, dhe intervistat me studentë do të bëhen në gjuhën angleze.

Kontratat për master në Menaxhim të Shëndetësisë dhe master në Mekatronikë janë nënshkruar në fund të majit të këtij viti, ndërsa për dy drejtimet tjera që do të veprojnë në kuadër të Fakultetit Juridik, nënshkrimi është bërë dje. **J. Llapashtica**